



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEE
KËSHILLI

Nr. 8156/5 Prot.

Pogradec, më 14.08. 2023

VENDIM

NR. 86, DATË 11.08.2023

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT PËR ZHURMAT

Ne baze te Ligjit 50/2023 Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr .9774, datë 12.07.2007,"Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis"të ndryshuar. Ligjit 139/2015 " Per Veteqeverisjen Vendore " Neni 26 pika 2, Udhezi mit Nr 1 date 07.01.2018 "Për kerkesat minimale për hartëzimin startegjik të zhurmës", Udhëzimin Nr.1 date 19.02.2018"Për miratimin e kërkesave minimale për hartimin e planeve të veprimit për zhurmat":

KËSHILLI BASHKIAK


VENDOSI:

1. Miratimin e Planit te Veprimit per Zhurmat te Bashkise Pogradec.
2. Miratimin e hartës së zhurmave për Bashkinë Pogradec.
3. Ngarkohet Inspektoriati i Mjedisit të Bashkisë , dhe Sektori i Transporteve & Supervizimit të Shërbimeve per zbatimin e ketij plani.
4. Ky vendim hyn ne fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARE E KËSHILLIT

Manjola KAMOLLI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEE
DREJTORIA E KONTROLLIT DHE MBROJTJES SË TERRITORIT
INSPEKTORIATI I MBROJTJES SË TERRITORIT MJEDISIT DHE UJRAVE

Pogradec, më ____ . ____ .2023

PLANI I VEPRIMIT PËR ZHURMAT BASHKIA POGRADEC

KREU I

Qellimi i këtij plan veprimi është:

1. Analizimi i situatës së ndotjes akustike në territorin e Bashkisë Pogradec, duke marrë veprim konkret për matjen e ndotjes akustike si dhe dendësive të trafikut.
2. Krijimi i hartës së zhurmave të Bashkisë Pogradec duke bërë matje konkrete.
3. Marrja e masave konkrete për eliminimin e zhurmave në afatet kohore të përcaktuara nga qarta në kreu II të Objektivat.
4. Integrimi i këtij plani me planin kombëtar për menaxhimin e zhurmave si dhe financimin të pjesëshëm nga Qeveria për akseset kombëtare rrugore dhe të transportit hekurudhor.

KREU II

Objektivat e planit të veprimit për zhurmat

1. Identifikimi i burimeve që gjenerojnë zhurmë dhe shkaktojnë ndotje akustike.
2. Vlerësimi i secilit burim zhurmë që krijon ndotje akustike si janë; transporti, aktivitetet sociale (pabe apo diskoteka), transporti hekurudhor si dhe ndotje akustike që gjenerohet nga veprimtaria e biznesit.
3. Zbatimi me rigorozitet të kuadrit ligjor për mbrojtjen akustike duke ndermarrë masa konkrete të cilat do të gjëni në vazhdim.
4. Mbrojtja e shëndetit të qytetarëve nga zhurmat si dhe koordinimi me institucionet e tjera për përmirësimin e kushteve të punës në subjektet e mëdha që gjenerojnë zhurmë në ambientet e brendshme të punës.

KREU III

Masat që duhen marrë për eliminimin e ndotjes akustike

1. Shpallja e zonave të qeta ku nuk mund të ketë aktivitetet sociale si (bar-kafe, koncerte industriale) me qëllim mbajtje të nivelit të zhurmave sipas udhëzimit Nr.8 datë 27.11.2007 (për nivelet kufi të zhurmave në mjediset e caktuara).
 - a. Zona të qeta do të jenë në territorin e Bashkisë Pogradec, **sipas hartave bashkëngjitur**.
2. Vendosja e sinjalistikës vertikale standarte me tabele që identifikon mosperdorimin e borisave të makinave pranë objekteve shpirtërore, social-kulturore, arsimore, konvikte, gjykates, institucioneve administrative si dhe në zona me dendësi të lartë banimi (brenda vitit 2023).
3. Forcimi i procedurave të dhenies së lejes së ushtrimit të aktivitetit 24 orë për të gjithë subjektet e përmendura në pikën 2 të këtij kreu nuk do të jepet leje në një distancë jo më pak se 100m në të gjitha drejtimet veri - jug, lindje - perëndim.
4. Lejet 24 orë, me pare duhet të marrin dhe mendimin e Policisë së Shtetit për aktivitetet



- sociale te cilet mund te jene shqetesim per prishjen e rendit dhe qetesise publike.
5. Lejet 24 ore per subjekte te vecanta si pab ose diskoteka nuk do te jepen pa ekspertizen (akustike) e Inspektoriatit te Mjedisit te Bashkise, Agjensise Kombetare te Mjedisit ose Eksperte Mjedisor te Licensuar ku te jene vendosur kriteret dhe masa konkrete per mbrojtjen akustike si brenda ambienteve edhe jashte tyre duke u bazuar ne legjislacionin ne fuqi.
 6. Përcaktimi i terminaleve te transportit nderqytetas te udhetareve me qellim reduktimin e trafikut te rnjeteve te renda ne zona me dendesi te larte banimi.

KREU IV

Analiza finaciare per zbatimin e ketij plani si dhe masat administrative.

1. Per zbatimin e ketij plani Bashkia ka nevojte:
 - a. per blerjen e nje aparati te certifikuar per matjen e zhurmave dhe vibrimeve
 - b. trajnimin e 2 Inspektoreve te Inspektoriatit te Mjedisit te Bashkise qe do te behet prane nje Eksperti Mjedisor te Licensuar, masat administrative do ti referohen ligjit 9774 dt 12-07-2007.
 - i. Aparat i certifikuar cope 1.700 Euro
 - ii. Trajnim Inspektoret 20.000 leke.
2. Harta e nivelit te zhurmave ne territorin e Bashkise Pogradec eshta harta bashkangjitur,
3. Vendosja e tabelave te sinjalistikes vertikale per ndalimin e perdorimit te borise se makines qe do te zbatohet nga sektoret ne bashki dhe NMI, Bashki.

Furnizim vendosje table vertikale	cope	12.000 lek
Nevojat fillestare table vertikale	cope 20	
	Totali	240.000leke

Nivelet kufi te zhurmave te lejuara sipas Udhezimit Nr. 8 date 27.22.2007 i Ministris te Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujerave dhe Ministris te Shendetesise jane si me poshte :

ANEKSI I

NIVELET KUFIT ZHURMES PER MJEDISE TE CAKTUARA

Mjedisi	Efekti kritik ne shendet	LAeq (dBA)	Koha Baze (ore)	LAmx Fast (dB)
Zona banimi				



Jashte banese	Bezdi (shqetesim) serioze gjate dites dhe mbremjes	55	16	-
	Bezdi (shqetesim) i moderuar gjate dites dhe mbremjes	50	16	-
Ne brendesi te banesave	Kuptueshmeri e bisedes dhe (bezdi) shqetesim i moderuar gjate dites dhe mbremjes	35	16	-
Ne brendesi te dhomes se	Prishja e gjumit naten	30	8	-
Jashte dhomes se fjetjes	Prishje e gjumit. dritare e hapur (vlera nga jashte)	45	8	-
Institucione				
Klasa mesimi, institucione- mjedise parashkollore (brenda)	Kuptueshmeri e bisedes, veshti resi ne kuptimin e infonacionit komunikimin e mesazhit	35	Gjate mesimit	-
Dhomat e fjetjes ne kopshte (brenda)	Prishje e gjumit	30	Koha e gjumit	-
Oborri i shkolles, vendet e loirave ne	Bezdi (shqetesim) - (burime te jashtme)	55	Koha e pushimit	-
Spitale, salla, dhoma (brenda)	Prishja e gjumit naten	30	8	40
	Prishja e gjumit dite dhe ne mbremje	30	16	
Spitale, salla trajtimi (brenda)	Ndikim ne pushim, (clodhje)	# 1		
Zona me aktivitetet social- ekonomik				
Zona industriale, tregtare, qarkullimi trafiku (mjedis i jashtem dhe i brendshem)	Dentim degjimi	70	24	110
Miedjs urban				
Mjedise publike, te jashtme apo te brendshme	Dentim degjimi	85	1	110
Ceremoni, festivale dhe argetime	Dentim degjimi (klientet < 5 here/vit)	100	1	110
Muzike nepermjet kufjeve te degjimit	Dentim degjimi	85 # 4	1	110
Tinguj -zhurme impulsive nga fishekzjarret dhe armet e zjarrit	Dentim degjimi (te miturit) Dentim degjimit (femijet)	-	-	140#2 120#2



Parqe publike				
Parqet natyrore dhe zonat e mbrojtura	Prishje e qetesise	#3		

Shpjegime:

LAeq (dBA) = Ni veli ekuivalent I matur ne shkallen A.

Koha baze (ore) = Koha gjate se ciles behet matja.

LAmx Fast (dB) = Niveli i matur ne shkallen A ne menyren fast (e shpejte).

1 = Sa me e ulet qe te jete e mundur.

2 = Presioni zanor maksimal (LAmx. fast) matur 100 mm larg veshit.

3 = Zonat e jashtme te qeta duhet te mbrohen dhe raporti i zhurmes hyrese/shtese me zhurmen e fonit natyral duhet te ruhet sa me i ulet qe te jete e mundur.

4 = Nen kufjet e degjimit, pershtatur me vlerat e fushes se lire.

- **Për zbatueshmërinë e këtij plani, pjesë përbërëse e tij është dhe harta e zhurmave sipas zonave të përcaktuara në Aneksin 1.**

**** Zonat jashtë kufijve të zonave urbane (sipas hartës) janë të lejuara aktivitete sociale, kulturore të cilat gjenerojnë zhurmë por gjithnjë Brenda limiteve të përcaktuara ligjore për dëmtimin e shëndetit të klientëve dhe punonjësve.**



Handwritten signature in blue ink.